



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 15, Datë 15.01.2026

MBI

**PËRCAKTIMIN E VLERËS SË DETYRIMIT PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATËS  
SË GARANCISË SË ORIGINËS PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 21 të Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.01.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 167 prot., datë 14.01.2026, “Mbi përcaktimin e vlerës së detyrimit për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për vitin 2026”,

**Konstatohet se:**

- Në mbështetje të nenit 22 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 300, datë 30.12.2024, ERE ushtron funksionin e organit lëshues të garancive të origjinës dhe, në këtë cilësi, transferon kostot e administrimit të regjistrimit elektronik të garancive të origjinës tek mbajtësit e certifikatave, përmes një tarife vjetore për njësi, e cila miratohet çdo vit nga Bordi i ERE-s jo më vonë se data 31 janar.
- ERE është pjesë e sistemit rajonal të Komunitetit të Energjisë për garancitë e origjinës dhe ushtron funksionet e organit lëshues përmes regjistrimit elektronik të garancive të origjinës, i cili është krijuar dhe mirëmbahet nga ofruesi i përzgjedhur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, aktualisht European Energy Exchange AG (ish-Grexel Ltd); njëkohësisht, ERE është anëtare e Shoqatës së Organeve Lëshuese (AIB), e cila administron Sistemin Evropian të Certifikatave të Energjisë (EECS), duke siguruar përputhshmërinë dhe njohjen ndërkombëtare të garancive të origjinës të lëshuara në Republikën e Shqipërisë.
- Në kushtet kur gjatë viteve 2024–2025 ERE ka mbuluar kostot e funksionimit të regjistrimit elektronik të garancive të origjinës dhe anëtarësimit në AIB, si dhe duke pasur parasysh mungesën e kërkesave për lëshimin e garancive të origjinës gjatë vitit 2025 për shkak të kushteve të tregut dhe mungesës së njohjes së tyre në BE, në zbatim të nenit 21, pika 6 të Rregullores, diferencat e krijuara do të reflektohen dhe korrigojnë në përcaktimin e detyrimit për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për vitin 2026.
- Referuar raportimeve të Sektorit të Ekonomisë dhe Financës, ERE ka kryer gjatë viteve të mëparshme dhe ka planifikuar për vitin 2026 pagesat e nevojshme ndaj ofruesit të regjistrimit

elektronik të garancive të origjinës dhe Shoqatës së Organeve Lëshuese (AIB), në funksion të administrimit të sistemit të garancive të origjinës, dhe këto shpenzime përbëjnë bazën e kostos që merret në konsideratë për përcaktimin e detyrimit për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për vitin 2026.

- Sasia e energjisë elektrike e prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë elektrike gjatë vitit 2025, bazuar në të dhënat paraprake të operatorëve të rrjetit, përlogaritet të jetë rreth 8 milion MWh. Për efekt të përcaktimit të vlerës së detyrimit për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për vitin 2026, do të llogaritet bazuar në 50% të sasisë së lartpërmendur ose 4 milionë MWh.
- Në bazë të të dhënave të operatorëve të rrjetit për prodhimin nga burimet e rinovueshme gjatë vitit 2025, dhe në zbatim të nenit 21 të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, është përcaktuar sasia e energjisë që merret në konsideratë për llogaritjen e detyrimit për vitin 2026, duke reflektuar qasjen e parashikuar në Rregullore dhe kushtet aktuale të tregut.
- Vlera e detyrimit për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për vitin 2026 është përlogaritur në përputhje me nenin 21 të Rregullores, bazuar në kostot e administrimit të sistemit dhe sasinë e energjisë të marrë në konsideratë për lëshimin e garancive të origjinës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Miratimin e vlerës detyrimit për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për vitin 2026, prej 0.03 Euro/MWh.
2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**